20-vjeçarit që gjuajti me armë te koncerti i Mozzikut, i gjenden disa armë të tjera në shtëpi

29 korrik 2023, 09:11

Shpërndaje në

Një 20-vjeçar është arrestuar të premten pasi ka shtënë me armë në oborrin e një diskoteke në Gjilan dhe ka hedhur një granatë dore, e cila nuk kishte shpërthyer.

Sipas dy punëtorëve të sigurimit në diskotekë, 20-vjeçari ishte afruar afër hyrjes se diskotekës dhe kishte shtënë me armë zjarri ne drejtim të ankuesve, e më pas kishte hedhur edhe granatën.

Nga të shtënat me armë zjarri është dëmtuar një automjet i cili ishte i parkuar ndërsa të lënduar nuk ka pasur.

Policia më pas ka bastisur shtëpinë e të dyshuarit dhe aty ka gjetur disa armë.

"Në koordinim me Prokurorinë Themelore në Gjilan, njësitet policore gjatë bastisjes në shtëpinë e të dyshuarit kosovar kanë gjetur e sekuestruar: tri armë gjuetie, një pistoletë dhe 16-copë fishekë cal-9x19 mm, në pronësi të prindit të dyshuarit, ndërsa është konfiskuar edhe një pistoletë e tipit TT, e cila dyshohet të jetë përdorur në rast", thuhet në raportin ditor të PK-së.

Për shkak të këtij rasti, ishte ndërprerë edhe performanca e këngëtarit Mozzik i cili ishte në skenën e diskotekës në momentin kur i riu shtiu.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#DISKOTEKE #ARME #MOZZIK

Kërkohet paraburgimi i qytetarit që e kanosi deputeten e PDK-së në Facebook

23 vjet burgim pesë personave që e detyruan një vajzë të kryente marrëdhënie seksuale për para

11 armë pa leje sekuestroi Policia të premten, shumicën në Prishtinë

Plagoset një djalë në Prishtinë

Vrasja në Lipjan: Policia gjeti dy revole në shtëpi

Tre të vrarë në Lipjan

Tentim vrasje në Pejë, Policia e ndjek pas të dyshuarin

TaboOla Feed

Një produkt i harruar që mund të pastrojë enët e gjakut.
Si të pastroni enët e gjakut dhe të ulni kolesterolin
Kryekardiologu i Shqipërisë | Sponsored
Lexo më shumë

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Kovaçiq: Guardiola është i një niveli tjetër
Mateo Kovaçiq e ka vlerësuar Pep Guardiolan si trajnerin më të mirë në botë, pas vetëm dy javë pune me të te Manchester City. Mesfushori kroat u transferua te City nga Chelsea në …
Kohanet



Nëse vuani nga presioni i lartë i gjakut, lexoni këtë tani!
Provojeni këtë para se të shkoni në shtrat: venat mund të pastrohen
Kryekardiologu i Shqipërisë | Sponsored
Lexo më shumë

TË TJERA

Aktakuzë ndaj një serbi për krime lufte në Kosovë

Gjuajtje me armë e hedhje të granatës, ndërpritet koncerti i Mozzikut në Gjilan

Një 28-vjeçar gjendet i vdekur brenda veturës në Prishtinë

Porositi vrasës me pagesë për ta ekzekutuar bashkëshortin shqiptar, arrestohet gruaja në Itali

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!